



R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
AUTORITETI I KONKURENCËS
DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLIGJISË SË TREGJEVE

NJOFTIM

Rasti: Përftimi i kontrollit të shoqërive GGE Ireland Limited dhe EMP Energy Limited nga shoqëria Statkraft Ireland Limited.

Me shkresën nr. 365/8, datë 01.08.2023 “Njoftim përqendrimi dhe kërkesë për autorizim të përqendrimit”, jemi njoftuar mbi nënshkrimin e marrëveshjes së shitblerjes së aksioneve të shoqërive EMP Energy Limited dhe GGE Ireland Limited nga shoqëria Statkraft Ireland Limited.

Referuar “Marrëveshje për shitblerjen e aksioneve”, palët pjesëmarrëse në transaksion janë:

Pala blerëse: Statkraft Ireland Limited është një shoqëri irlandeze me përgjegjësi të kufizuar, e cila zhvillon, ndërton, zotëron dhe operon projekte të energjisë së rinovueshme. Kjo shoqëri është e përfshirë në gjenerimin, transmetimin, shpërndarjen dhe furnizimin e anergjisë elektrike.

Statkraft Ireland Limited zotërohet 100% nga shoqëria Statkraft AS, shoqëria mëmë e disa filialeve të Grupit Statkraft.

Grupi Statkraft është prezent në Shqipëri përmes dy filialeve të saj, Statkraft Renewables Albania SHPK dhe Devolli Hydropower SH.A., të cilët operojnë në tregun e prodhimit të energjisë elektrike.

Shoqëria Target 1: GGE Ireland Limited është një shoqëri irlandeze, me përgjegjësi të kufizuar, me objekt aktiviteti zhvillimin e aseteve të prodhimit të energjisë nga era, dielli dhe ruajtja e energjisë nëpërmjet baterive. GGE Ireland Limited zotërohet tërësisht nga shoqëria Galileo Green Energy GmbH, shoqëri zvicerane e cila ushtron veprimtari tregtare si zhvilluese dhe operatore mbarë evropiane, multi-teknologjike e energjisë së rinovueshme.

Shoqëria Target 1 nuk është prezent dhe nuk gjeneron xhiro në Shqipëri.

Shoqëria Target 2: EMP Energy Limited është një shoqëri irlandeze, me përgjegjësi të kufizuar, me objekt aktiviteti zhvillimin e aseteve të prodhimit të energjisë nga era, dielli dhe ruajtja e energjisë nëpërmjet baterive. EMP Energy Limited zotërohet 50% nga shoqëria GGE Ireland Limited, 25% nga shoqëria Emerging Markets Power (Holdings) Limited dhe 25% nga shoqëria Wind Power Invest A/S.

Shoqëria Target 2 nuk është prezent dhe nuk gjeneron xhiro në Shqipëri.

GGE Ireland Limited dhe **EMP Energy Limited** janë themeluar për të lehtësuar zhvillimin e aseteve të prodhimit të energjisë nga era, dielli dhe ruajtjen e energjisë nëpërmjet baterive.

Pala shitëse:

Shitësi 1: Galileo Green Energy GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Zvicrës, me veprimtari tregtare si zhvilluese dhe operatore mbarë-evropiane, multi-teknologjike e energjisë së rinovueshme. Galileo Green Energy GmbH zotëron 100% të aksioneve të shoqërisë GGE Ireland Limited.

Shitësi 2: Wind Power Invest A/S është një shoqëri tregtare, e themeluar sipas legjislacionit të Danimarkës, me objekt aktiviteti projektimin, prodhimin dhe instalimin e turbinave me erë në të gjithë globin.

Wind Power Invest A/S zotëron 25% të kapitalit themeltar të shoqërisë Target 2.

Shitësi 3: Emerging Markets Power (Holdings) Limited është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit anglez, me objekt aktiviteti: prodhimin, transmetimin, shpërndarjen dhe tregtimin e energjisë elektrike.

Emerging Markets Power (Holdings) Limited zotëron 25% të kapitalit themeltar të shoqërisë Target 2.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.